



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7514 Prot.

Roskovec, më 26.12 2019

VENDIM

Nr. 116 datë 20/12/2019

PËR

ANULIM TË VENDIMIT NR.106 DATË 22.11.2019
“PËR MIRATIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR TË PËRFUNDUAR, PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KRYESIVE DHE KRYETARËVE TË
FSHATRAVE NËN JURIDIKSIONIN TERRITORIAL TË BASHKISË ROSKOVEC”

*Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 70, Ligjit
Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113, shkresës
Nr.1825/1 datë 05.12.2019 të Prefektit të Qarkut Fier, Këshilli i Bashkisë,*

VENDOSI:

1. Anulimin e VKB Nr.106 datë 22.11.2019 “Për miratimin e procesit zgjedhor të përfunduar, për zgjedhjen e anëtarëve të Kryesive dhe Kryetarëve të fshatrave nën juridiksionin territorial të Bashkisë Roskovec”.

Në shkresën Nr.1825/1 datë 05.12.2019 “Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec” Prefekti i Qarkut Fier e kthen këtë vendim jo në përputhje me nenin 70 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Sipas pikes 5 të këtij neni, përcaktohet se këshilli bashkiak ka vetëm detyrimin e mbikqyrjes së procesit dhe veprimtarisë së kryesisë. Kryetari i fshatit zgjidhet nga anëtarët e kryesisë së fshatit ndërsa kjo e fundit zgjidhet me votim, në mbledhjen e fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se ngjysma e banorëve me të drejtë vote.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Sekretaria e Këshillit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

